



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AD/GJKK/2/23

Kryetari i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Mahir Tutuli, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga B.H. – Kryeshefe Ekzekutive e Telekomit të Kosovës, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.T., bazuar në dispozitën e Nenit 9 paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 17.08.2023, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga B.H. – Kryeshefe Ekzekutive e Telekomit të Kosovës ndaj gjyqtarit A.T., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

B.H. – Kryeshefe Ekzekutive e Telekomit të Kosovës, në cilësi të përfaqësueses së palës në procedurë përmbartimore, me datë 09.08.2023, përmes parashtrësës dërguar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.T..

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 01.08.2023 i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës Komerciale se në rastin konkret në bazë të Nenit 9, paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kur ankesa i drejtohet Autoritetit Jo-Kompetent, Autoriteti i tillë do të transferojë ankesën tek Autoriteti Kompetent duke e njoftuar dërguesin për këtë.

Parashtruesja e ankesës B.H. në cilësi të Kryeshefes së debitorit Telekomit të Kosovës, ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit A.T. me pretendime se, gjyqtari ka treguar anshmëri në dëm të debitorit duke mos i zbatuar udhëzimet dhe sugjerimet e gjykatave të instancave më të larta. Andaj ka pretenduar se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara me Nenin 5 par.1 nenpar. 1.2 dhe 1.3 dhe par. 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ka theksuar se mënyra dhe shkeljet që kanë lejuar të arrihet tek ky rezultat i kundërligjshëm dhe absurd në formë të përmbledhur përfshijnë shkeljet si në vijim:

Ekspert i caktuar nga Gjykata në këtë lëndë ka qenë F.B., i cili ka paraqitur "Ekspertizë financiare" të dt. 22.06.2020 tek Gjykata Themelore në Prishtinë, [PPP.nr. 1486/19] për të

njëjtën lëndë. Sipas Gjykatës Kushtetuese dhe të Apelit, objekt i trajtimit është ekspertiza e z. P., duke përfshirë edhe detyrimin për super-ekspertizë të re për shkak të shkeljeve esenciale të drejtës së Telekomit të Kosovës për të paraqitur argumentet e tij dhe pretendimet.

Gjykatësi pa asnjë aktvendim të nxjerrë në procedurë Gjyqësore, dhe në mënyrë kundërligjore pranon dhe vendos të pranoj si ekspert gjyqësor dhe të pranojë të gjitha konkludimet e z. R.S. si ekspert financiar, i cili si ekspert është caktuar nga përmbauesi Ilir Mulhaxha. Pra, një ekspertizë të përmbauesit sipas udhëzimeve të Dardafon e konverton në ekspertizë gjyqësore. Kjo edhe pse në raportin e ekspertizës ceket shumë qartë nga përpiluesi R.S. se ekspertiza është përpiluar tërësisht me të dhënat e pranuar vetëm nga Kreditori — Dardafon.net L.L.C. Kjo ekspertizë e z. R.S. është përgatitur vetëm një (1) ditë pas vendimit paraprak dhe të anuluar të Dhomës së Shkallës së Parë të Gjykatës. Tutje, përmes kësaj ekspertize paraprakisht ishte shtantazhuar Telekomit, kur përmes postës elektronike, përmbauesi privat Ilir Mulhaxha, në ora 12.11 PM, i është drejtuar Kryeshefes Ekzekutive të debitorit-Telekomi i Kosovës sh.a-Prishtinë (B.H.), me kërkesë që pasi ka pranuar Ekspertizen Financiare të dt.31.10.2022, punuar nga Eksperti R.S., të kryejë pagesën e menjëhershme, brenda afatit 24 orësh.

Gjykatësi refuzon të drejtën që të trajtohen provat e paraqitura nga Telekomit i Kosovës për pagesat e bëra nga Debitori dhe të pakontestuar nga Kreditori, pa asnjë bazë ligjore, refuzon plotësimin e ekspertizës dhe caktimin e një ekspertize të re, përkundër udhëzimeve dhe kërkesave të qarta të Gjykatës Kushtetuese dhe të Apelit dhe detyrimeve ligjore.

Gjykatësi refuzon të njohë pagesat e bëra nga Telekomit i Kosovës në kuadër të "Marrëveshja për ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Arbitrazhit 20990/MHM" të nënshkruar mes Kreditorit dhe Debitorit me datën 24.05.2017. Kjo Marrëveshje paraqet Akt Noterial ("Act en minute") Nr. i LRP: 6316/2017 dhe Nr. i REF: 1202/2017 të përpiluar nga Noteri Sefedin Blakaj dhe në bazë të së njëjtës Dardafon ka pranuar minuta/numra dhe shërbime tjera (.3G dhe 4G.), të cilat kanë vlerë financiare të matur dhe duhet thyer në kalkulimin e borxhit. Gjykata në mënyrë selektive ka njohur vetëm një pjesë të kompenzimeve në kuadër të kësaj Marrëveshje, derisa për tjerat në mënyrë kundërligjore dhe diskriminuese deklaroi se nuk ka kompetencë.

Gjykatësi ka refuzuar çdo kërkesë procedurale të Telekomit të Kosovës dhe ka bërë interpretime të gabuara të ligjit duke qenë i orientuar vetëm tek një qëllim "lejimin e përmbarimit sipas ekspertizës së paligjshme të z. R.S., i cili nuk ishte fare i caktuar nga Gjykata". Kështu që qëllimi ishte të pengohej çfarëdo vërtetimi i të vërtetës dhe trajtimi i provave të paraqitura nga Telekomit Kosovës.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtari A.T. me parashtrësën e datës 14.08.2023, ka deklaruar se:

E gjithë përmbajtja e Ankesës ka të bëjë me pretendime për shkelje të Dispozitave të Procedurës Kontestimore dhe Përmbarimore me pretendime për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e edhe me pretendime të aplikimit të gabuar të dispozitave të Ligjit material. Pra, të gjitha këto janë baza të ankimit dhe me këtë rast parashtruesja e Ankesës Telekomit i Kosovës Sh.A në Prishtinë, bazat e njëjta të ankimit është munduar t'i përdor edhe në Ankesën për shkelje disiplinore.

Konsiderojë se është njohuri elementare se Gjykatat veprojnë në bazë të Kushtetutës dhe Ligjeve, dhe Gjykatat duhet t'i zbatojnë sugjerimet e instancave më të larta brenda Dispozitave

Kushtetuese dhe Ligjore dhe jo jashtë atyre sepse udhëzimet dhe qëndrimet e Gjykatës së Shkallës së dytë nuk mund t'i mbizotërojnë Dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit. Në këtë drejtim konsideroj se me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit, i kam zbatuar drejtë Dispozitat Procedurale, e kam vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe e kam zbatuar drejtë ligjin material. Kjo ishte vetëm si deklaratë e imja, por për të njëjtat pretendime do të vendos instanca më e lartë gjyqësore.

*Pra, pretendimet ankimore nga pika 1 deri tek pika 16 janë de fakto ankesë kundër Aktvendimit, prandaj nuk do të deklarohej më shumë. Në pikën 17 të Ankesës thuhet se Gjyqtari i çështjes Alajdin Tërshnjaku **gjatë tërë procedurës përmbartimore...** ka treguar shumë qartë anshmëri të skajshme në dëm të Debitorit?!*

Ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm dhe kontradiktor me vet veprimet procedurale të Debitorit të përmbartimit. Sepse kur thuhet gjatë tërë procedurës përmbartimore, lë të kuptohet se Debitori paska qenë në dijeni të “anshmërisë së skajshme” por nëse qëndron ky pretendim pse nuk e ka ngritur çështjen e kësaj “anshmërie të skajshme” përpara se të pranonte Aktvendimin e fundit ndaj të cilit ka paraqitur Ankesë, gjegjësisht pse nuk e ka paraqitur Kërkesën për përjashtimin tim lidhur me vendosjen në këtë çështje?

Mënyra e përshkrimit të “anshmërisë së skajshme” sipas ankueses përkufizohet se gjoja nuk i kam zbatuar udhëzimet dhe sugjerimet e Gjykatave të instancave më të larta (madje as pa i precizuar Gjykatat dhe pa i precizuar Udhëzimet dhe Sugjerimet e tyre)!

Ky pretendim nuk përmban precizim dhe është abstrakt sepse nuk përshkruan cilin udhëzim dhe sugjerim të cilës Gjykatë nuk e paskam zbatuar unë në cilësi të gjyqtarit? Mos zbatimi eventual i udhëzimeve dhe sugjerimeve të Gjykatave më të larta paraqet bazë për Ankesë të rregullte dhe nuk është bazë për Ankesë për shkelje disiplinore, edhe po të ekzistonte një gjë e tillë, por në rastin konkret nuk ka precizim se cili udhëzim dhe cili sugjerim nuk është zbatuar?!

Mos zbatimi i një udhëzimi apo sugjerimi të një Gjykatë të instancës më të lartë do të paraqiste shkelje qoftë të Ligjit të procedurës kontestimore apo Përmbartimore, qoftë të ndonjë ligji material. Pretendimi abstrakt për mos zbatim të udhëzimeve dhe sugjerimeve, sigurisht se do të paraqiste ndonjë trajtë të mos aplikimit të drejtë, qoftë të dispozitave procedurale, qoftë të dispozitave materiale. Në rastin konkret nuk ka as pretendime për shkeljen e një dispozite të vetme procedurale, apo shkeljen e ndonjë dispozite të Ligjit material, prandaj nuk e kam të çartë në aspektin teorik si mund të mos zbatohen udhëzimet dhe sugjerimet e një Gjykate pa shkelur ndonjë dispozitë të Ligjit.

Pra, Ankesa për shkelje disiplinore me pretendim se “ekzistojnë rrethana të shumta...” është një Ankesë SUI GENERIS sepse nën supozimin e rrethanave të shumta apo të pakta e pa u precizuar ato rrethana nuk mund të deklarohej lidhur me atë se çka ekziston në kokën e hartuesit të kësaj Ankese. Prandaj, përmes të ashtu quajturave rrethana të shumta e që për neve janë misterioze, nuk mund të ketë shkelje as të një ligji e as të kodit të etikës profesionale për gjyqtarë.

Parafrazimet e Kodit të Etikës profesionale për gjyqtarë, në pikën 17 janë të përshkruara në mënyrë të drejtë nga Kodi, por këto Dispozita as nuk janë shkelur nga ana ime e as nuk mund të shkelen vetëm me supozimin se po ekzistuan rrethana të shumta për të cilat tani për tani janë një mister.

*Konsideroj se gjatë gjithë procedurës jam munduar maksimalisht të jem i kujdesshëm në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore dhe Kontestimore. **“Faktet***

krijojnë bindjet, e jo bindjet faktet” mbi këtë parim i kam formuar bindjet e mia dhe mbi bazën e bindjeve të mia e kam aplikuar drejtë Ligjin procedural dhe Ligjin material.

Autoriteti kompetent, nga pretendimet e palës ankuese ka gjetur se shkeljet e pretenduara disiplinore konsistojnë në: njëanshmëri të gjyqtarit të çështjes dhe mos-zbatim të udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Komerciale të Kosovës pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës vlerëson se, në rastin konkret pala ankuese nuk ka arritur të provojë pretendimet për njëanshmërinë e gjyqtarit, të cilat janë objekt i kësaj ankese disiplinore.

Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 25.04.2023 rezulton se përfaqësuesit e debitorit nuk kanë ngritur asnjë shqetësim apo vërejtje lidhur me anshtmërinë e gjyqtarit dhe e kanë nënshkruar procesverbalin pa asnjë vërejtje, edhe pse kanë pasur mundësi ligjore që t'i paraqesin vërejtjet e tyre. Përfaqësuesit e debitorit, në rast të dyshimit për njëanshmëri të gjyqtarit kanë pasur mundësinë ligjore të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit por nuk kanë kërkuar një gjë të tillë.

Dyshimet lidhur me njëanshmërinë e gjyqtarit janë ngritur pas marrjes së vendimit dhe nga Kryeshefja ekzekutive e debitorit e cila nuk ka marrë pjesë në seancë andaj deklaratimet e saj lidhur me zhvillimin e procedurës dhe ruajtjen e paanshmërisë së gjyqtarit nuk mund të merren parasysh dhe nuk përbëjnë fakte mbi të cilat mund të konstatohet ndonjë shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit. Këto pretendime nuk përputhen as me vetë qëndrimet e përfaqësuesve profesional të debitorit në procedurën e zhvilluar dhe në asnjë provë konkrete që do të vërtetonte njëanshmëri të gjyqtarit.

Të njëjtat pretendime janë përdorur si baza ankimore në ankesën e parashtruar ndaj vendimit të Gjykatës Komerciale KPP.nr.365/2023, të datës 17.07.2023, dhe nuk mund të shërbejnë në të njëjtën kohë edhe si bazë për procedurë disiplinore sepse në procedurën disiplinore objekt shqyrtimi dhe vlerësimi mund të jenë shkeljet e natyrës disiplinore e jo ato të natyrës procedurale apo materiale, të cilat janë kompetencë ekskluzive e gjykatës së instancës me të lartë.

Poashtu është i pa qëndrueshëm, pretendimi i parashtrueses për shkelje disiplinore të gjyqtarit për moszbatim të udhëzimeve të gjykatës më të lartë lidhur me caktim të ekspertizave dhe nuk përbën bazë për ndonjë shkelje disiplinore të përcaktuar me Nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L - 057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse është në diskrecionin e plotë të gjyqtarit të vlerësojë faktet vendimtare dhe mënyrën e të provuarit të atyre fakteve sidomos në procedurën përmbarimore ku vlen parimi i “formalitetit rigoroz” andaj gjyqtari vlerëson se cili është objekti i shqyrtimit dhe cilat fakte duhet vlerësuar për vendosjen e çështjes në procedurë përmbarimore.

Parashtruesja në rastin konkret ka kërkuar nga Kryetari i gjykatës – si Autoritet kompetent, të vlerësojë veprimet procedurale të gjyqtarit lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike respektivisht caktimin e ekspertizës financiare, përderisa për të vendosur lidhur me këtë çështje gjyqtari ka autorizime të plota ligjore ndërsa Kryetari i gjykatës nuk ka asnjë autorizim ligjor në këtë drejtim dhe çdo ndërhyrje apo vlerësim i veprimeve të gjyqtarit është i palejuar pasi përbën ndërhyrje në pavarësinë e gjyqtarit. Për më tepër nga shkresat e lëndës rezulton gjyqtari i çështjes në asnjë moment nuk ka treguar njëanshmëri dhe i ka vlerësuar me kujdes të gjitha pretendimet e debitorit lidhur me gjetjet nga ekspertiza financiare dhe propozimin për

ekspertizë tjetër dhe ka dhënë arsyetime të mjaftueshme nga pika 68 deri në pikën 73 të arsyetimit të Aktvendimit KPPP.nr.365/2023, dt.17.07.2023, duke shprehur qëndrimet e tij se kontestimet e debitorit nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë pasi sipas dispozitave të Nenit 69 dhe 71 të Ligjit për procedurën përmbartimore kompetencë e gjykatës në procedurën përmbartimore është vetëm vendosja sipas prapësimit ndaj urdhrit përmbartimor ndërsa për çështjet tjera të natyrës kompensuese i ka udhëzuar palët që ti adresojnë në procedurë kontestimore.

Prandaj, kontestimi i qëndrimeve të gjyqtarit mund të bëhet me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë dhe vetëm gjykata e shkallës së dytë mund t'i vlerësojë këto qëndrime në frymën e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të atakuar të shkallës së parë, por këto qëndrime të gjyqtarit të shkallës së parë nuk mund të vlerësohen nga Kryetari i gjykatës në frymën e shkeljeve disiplinore përderisa parashtruesja nuk ka argumentuar dhe nuk ekziston asnjë element i cili do të krijonte dyshimin se gjyqtari ka vepruar me paragjykim diskriminues ndaj palëve mbi çfarëdo baze, nuk i ka trajtuar siç kërkohet me ligj palët në procedurë, u ka komunikuar personave të paautorizuar informata jo-publike të marra gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, ka pranuar çfarëdo lloj dhurate ose shpërblimi që mund të çojë ose duket se çon në ndikim të paligjshëm në vendimet dhe veprimet zyrtare, ka keqpërdor pozitën zyrtare në çfarëdo forme për përfitime të paligjshme për veten ose personat e tjerë ose për qëllime tjera në kundërshtim me ligjin, nuk ka raportuar rastin e përjashtimit të mundshëm nga procedura kur kërkohet me ligj, është përfshirë në çfarëdo komunikimi ex-parte lidhur me lëndën, apo rastet tjera të përcaktuara me Nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L - 057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si shkelje disiplinore.

Pakënaqësitë e palëve lidhur me vendimin gjyqësor, konform ligjit, mund të parashtrohen me ankesë në instancën më të lartë gjyqësore, por nuk lejohet komentimi dhe kontestimi i vendimeve gjyqësore jashtë procedurave gjyqësore, si dhe paragjykimi i pabazuar në asnjë fakt se gjyqtari ka vendosur në mënyrë të njëanshme dhe ka kryer shkelje disiplinore.

Komentimi dhe kontestimi publik i vendimit gjyqësor dhe atakimi i gjyqtarit pa argumente faktike dhe profesionale, përderisa procedura gjyqësore është në zhvillim e sipër dhe nuk ka përfunduar, janë në kundërshtim me Nenin 107 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe me dispozitat ligjore dhe Instrumentet Ndërkombëtarë që garantojnë pavarësinë e gjyqtarëve nga çdo ndërhyrje nga jashtë dhe atë si në vijim:

I. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 107 [Imuniteti] 1. Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si gjyqtarë.

II. LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR GJYKATAT

Neni 4 Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatave 1. Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. 2. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.

III. Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit Miratuar nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara, të mbajtur në Milano me 26 Gusht deri më 6 Shtator 1985 dhe e miratuar nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 - 29 Nëntor 1985 dhe 40/146 -13 Dhjetor 1985.

1. Pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet nga Shteti dhe të ruhet me Kushtetutën apo ligjin e shtetit. Është detyrë e të gjithë qeveritarëve dhe institucioneve të tjera që të respektojnë dhe vëzhgojnë pavarësinë e gjyqësorit. 2. Gjyqësori duhet të vendosë për çështjet para tyre paanësisht, duke u bazuar në fakte dhe në pajtim me ligjin, pa asnjë kufizim, ndikim të padrejtë, nxitje, presion, kërcënim apo ndërhyrje, direkte apo indirekte, nga ndonjë drejtim apo për çfarëdo arsye. 3. Gjyqësori duhet të ketë juridiksion mbi të gjitha çështjet të natyrës juridike dhe duhet të ketë autoritet ekskluziv për të vendosur nëse një çështje e dorëzuar për vendim të tij është brenda kompetencave të tij siç e parasheh ligji. 4. Nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të papërshtatshme apo të pajustificuar në procesin gjyqësor, e as vendimet gjyqësore nuk duhet t'i nënshtrohen kurrfarë rishqyrtimit. Ky parim është pa paragjykim për rishikim gjyqësor apo për zbutjen apo uljen e dënimit nga organet kompetente të dënimit e dhëna nga gjyqësori në pajtim me ligjin [...].

IV. Për më tepër Komisioni Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë në kuadër të Këshillit të Evropës, si organ ekskluziv për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve, përmes opinioneve të saj (të cilat opinione merren si referencë në aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kur flitet për statusin e gjyqtarëve) ka saktësuar qartazi parimet mbi bazën e të cilave duhet parandaluar rreziku i cenimit të pavarësisë së gjyqtarëve.

Në Opinionin e dhjetë (10) të këtij Komiteti, përcaktohet qartazi se shtetet duhet angazhohen që të mbrojnë gjyqtarët nga tendencat për të zgjeruar fushën e përgjegjësisë disiplinore të tyre, kjo pasi që në rast se një gjyqtar i ekspozohet procedurës disiplinore vetëm për shkak të qëndrimeve dhe bindjes së tij të shprehur në vendime, jo vetëm që cenohet pavarësia gjyqësore, por edhe balanci midis pushteteve në një shoqëri demokratike rrezikohet.

Në anën tjetër, përmes Opinionit nr. 18, që trajton pozitën e pushtetit gjyqësor dhe raportet me pushtetet tjera shtetërore në një shoqëri demokratike, në paragrafin 35 të saj, qartazi theksohet se në të gjitha rastet kur pretendohet për gabime në marrjen e vendimeve, mjeti i vetëm goditës duhet të jetë apelimi i tij në një instancë më të lartë gjyqësore. Tutje theksohet se çështja e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të gjendjes faktike në një rast konkret nga gjyqtari, në asnjë mënyrë nuk mund të paraqet bazë për iniciimin e një procedure disiplinore ndaj një gjyqtari, përderisa këto vlerësime nuk janë devijuar qëllimshëm.

Poashtu, me Opinionin 20 të këtij Komiteti, që flet për rolin e Gjykatave në aplikimin uniform të ligjit, përcaktohet qartë që një gjyqtar i cili nuk i bindet një praktike të unifikuar gjyqësore nga një gjykatë, dhe ofron arsyet për këtë, në asnjë mënyrë nuk duhet të dekurajohet për ndryshimin e asaj praktike, dhe se ky devijim në asnjë rrethanë nuk mund të paraqet bazë për iniciim të procedurës disiplinore apo të afektoj punën e tij si gjyqtar, por duhet parë si një element i pavarësisë së një gjyqësori.

Në rastin konkret, në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore parashtruesja në të gjitha pretendimet e saj i referohet shkeljeve të pretenduara lidhur me interpretimin e ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe pa asnjë kompetencë ligjore dhe profesionale jep vlerësimin e saj subjektiv lidhur me vendimin e gjykatës dhe veprimet procedurale si dhe

ligjshmërinë e tyre, edhe pse kjo bie në kompetencën ekskluzive të gjykatës së shkallës së dyte. Dhe në fund konstaton vetë edhe ekzistimin e shkeljes disiplinore pa argumentuar fare ndonjë devijim të qëllimshëm të gjyqtarit gjatë interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të gjendjes faktike, apo ndonjë shkelje tjetër disiplinore të sanksionuar me ligj, si kusht thelbësor për ngritjen e dyshimit dhe inicimin e procedurës disiplinore.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Komerciale të Kosovës lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

AD/GJKK/2/23, me datë 17.08.2023

Mahir Tutuli

Kryetar i Gjykatës Komerciale